



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
ëëë.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

RAPORTI / FORMULARI PËR VLERËSIM – F2

(E plotëson Komisioni Vlerësues-Recenzues)¹

Fakulteti	Juridik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	E drejta kushtetuese positive (3 orë O); E drejta administrative – pjesa e posaçme (Bsc 3 orë); Gjqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z);
Titulli shkencor për të cilën konkurren kandidati	Doktor i shkencave juridike – drejtimi kushtetues administrativ
Kandidatët e paraqitur:	Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha Dr.Sc. Lizë Rexhepi Dr.Sc. Basri Kastrati PhD c. Ahmet Imami Msc. Ritë Arifi

Komisioni Vlerësues:

- 1. Prof. Dr Sadik Haxhiu, kryetar**
- 2. Prof. Asoc. Dr. Liridon Dalipi, anëtar**
- 3. Prof. Ass . Dr. Detrina Alishani Sopi, Anëtare.**

¹ Anëtarët e Komisionit recensues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë dhe plotësimin e të dhënave të shënuara në këtë Formular (rregullorja nr. 01/120 datë 21.01.2025).

Komisioni vleresues, i formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit Juridik të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Ref.nr.62/25, dt. 18.02.2025, duke u bazuar në Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka", si dhe duke u bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin Publik " Kadri Zeka" Ref.nr.01/120 dt. 21.01.2025 dhe thirrjes publike për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në njësitë akademike të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan me Ref.nr. 01/199 dt.07/02/2025, për semestrin veror në vitin akademik 2024/2025, si dhe pas shqyrtimit të dosjeve dhe mbajtjes së intervistës së kandidatëve që kanë plotësuar kushtet formale juridike, për pozitën dy bashkëpunëtorë të jashtëm për mbajtjen e ligjeratave për lëndët: E drejta kushtetuese positive (3 orë O); E drejta administrative – pjesa e posaçme (Bsc 3 orë); Gjyqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z):

PROPOZON

Kandidati nr.1.

Prof. Asoc.Dr. Fejzulla Berisha, për bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ligjeratave nga fusha kushtetuese administrative për lëndët: E drejta kushtetuese pozitive dhe E drejta administrative – pjesa e posaçme.

Arsyetimi:

Pas mbajtjes së intervistës dhe shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni erdhi deri te ky propozim duke marrë për bazë që Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha i plotëson të gjitha kushtet e parapara ne Statutin e Universitetit " Kadri Zeka ", Rregulloren e procedurave vleresuese per angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin Publik " Kadri Zeka" Ref.nr.01/120 dt. 21.01.2025 dhe Thirrjes publike për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan me Ref.nr. 01/199 dt.07/02/2025. I njëjti ishte profesor i rregullt në këtë fakultet prej vitit akademik 2016/2019 dhe ka qenë bartës i këtyre lëndëve. Prej vitit akademik 2020/21 ka qenë i angazhuar deri më tani dhe se i njëjti ka paraqitur kërkesë me ref. Nr. 05/336 për angazhim edhe në semestrin veror të vitit akademik 2024/2025.

Kandidati nr.2.

Dr.Sc. Lizë Rexhepi për bashkëpunëtorë të jashtëm për mbajtjen e ligjeratave nga fusha kushtetuese administrative për lëndët: Gjyqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z).

Arsyetimi: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, Komisioni vlerësues konstatoi se kandidati i dytë Dr.Sc. Lizë Rexhepi i plotëson kushtet dhe kriteret formale juridike të përcaktuara në konkurs në raport me kandidatin e tretë z. Dr.Sc. Basri Kastrati. ky vlerësim mbështetet në disa arsye:

- Përputhshmëria akademike në fushën e kërkuar. Dr.Sc. Lizë Rexhepi ka përfunduar dy nivelet e studimeve: master dhe doktoraturë në fushën kushtetuese administrative, që është në përputhje të plotë me drejtimin akademik të lëndëve të shpallura në konkurs.
- Në bazë të kushteve të konkursit, përparësi kanë kandidatët që posedojnë njohuri akademike në gjuhë angleze. Kandidatja Lizë Rexhepi ka përfunduar studimet e masterit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke dëshmuar një nivel të avancuar të njohjes së gjuhës angleze, çka e bën të njëjtën më të favorizuar për këtë pozitë.

Duke u bazuar në këto aspekte, komisioni vlerëson se kandidatja Dr.Sc. Lizë Rexhepi i plotëson më së miri kushtet për bashkëpunëtorë të jashtëm për lëndët: Gjyqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z).

NUK PROPOZON

Kandidati nr.3.

Dr.Sc. Basri Kastrati i plotëson kushtet formale juridike për bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ligjeratave nga fusha kushtetuese administrative për lëndët: Gjyqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z), megjithatë dy kandidatët e propozuar Prof.Asoc.Dr. Fejzula Berisha dhe Dr.Sc. Lzë Rexhepi i plotësojnë më së miri kushtet për angazhim.

Dr.Sc. Basri Kastrati ka të përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik, studimet e masterit në fushën juridiko penale ndërsa studimet e doktoratës në fushën kushtetuese administrative.

Arsyetimi: Dr.Sc. Basri Kastrati ka qenë i angazhuar edhe vitin e kaluar bashkëpunëtor i jashtëm në lëndët e sipërpërmendura, megjithatë, komisioni konstatoi se dy kandidatët e sipërpërmendur të propozuar: Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha dhe Dr.Sc. Lizë Rexhepi dy nivelet e fundit të studimeve i kanë nga fusha kushtetuese administrative, ndërsa kandidati Dr.Sc. Basri Kastrati studimet master i ka nga fusha juridike penale dhe prandaj nuk e propozon për bashkëpunëtor të jashtëm për lëndët e sipërpërmendura.

Kandidati nr.4.

PhD. c. Ahmet Imami i plotëson kushtet formale juridike për bashkëpunëtor të jashtëm për lëndët: Gjyqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z).


Arsyetimi: kandidatët e propozuar Prof.Asoc.Dr. Fejzulla Berisha dhe Dr.Sc. Lizë Rexhepi i plëtojnë më së miri kushtet formale juridike, sepse e kanë titullin e doktorit të shkencave juridike drejtimi kushtetues administrativ dhe i kanë dy nivelet e fundit të studimeve nga fusha e kushtetuese administrative.

8
9
B


Msc. Ritë Arifi nuk i plotëson kushtet formale juridike, për bashkëpunëtor të jashtëm për lëndët: Gjyqësia kushtetuese, (2 orë Z); Rregullimi ligjor i databazave në E- qeverisja (2 orë Z) dhe Etika profesionale në E qeverisje (2 orë Z).

Arsyetimi: kandidatja në fjalë ka të kryer vetëm studimet e masterit kushtetues administrativ.

Komisioni Vlerësues:

4. Prof. Dr Sadik Haxhiu, kryetar _____ 

5. Prof. Asoc. Dr. Liridon Dalipi, anëtar _____ 

6. Prof. Ass . Dr. Detrina Alishani Sopi, Anëtare. _____ 

Gjilan, 27 shkurt 2025